



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



Kabineti i Kryetarit të Komunës

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 37, 38, 39 të LIGJIT NR. 06/L-082 PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE, Kryetari i Komunës, më datën 24.07.2025 bie këtë:

V E N D I M

I.Nëpunësi i shërbimit civil Lavdim Uka me Nr.personal 1030266478 Zyrtar i lartë i teknologjisë informative nga data 25.07.2025 caktohet ZYRTAR PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE.

Detyrat e zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave :

1. Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave ka, të paktën, detyrat e mëposhtme:

1.1. informon dhe këshillon kontrolluesin ose përpunuesin dhe të punësuarit, të cilët kryejnë përpunimin mbi detyrimet e tyre në pajtim me këtë ligj dhe aktet nënligjore për mbrojtjen e të dhënave; GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS /Nr. 6 / 25 SHKURT 2019, PRISHTINË 27 LIGJI NR. 06/L-082 PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

1.2. jep këshilla, sipas rastit, në lidhje me vlerësimin e ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave dhe monitoron performancën në pajtim me nenin 35 të këtij ligji;

1.3. bashkëpunon me Agjencinë;

1.4. vepron si pikë kontakti për Agjencinë për çështjet në lidhje me përpunimin, duke përfshirë konsultimin paraprak, të referuar në nenin 36 të këtij ligji dhe konsultohet, sipas rastit, në lidhje me çdo çështje tjetër.

2. Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave, në përmbushje të detyrave të tij ose të saj, merr parasysh si duhet rrezikun që shoqëron veprimet e përpunimit, duke marrë parasysh natyrën, objektin, kontekstin dhe qëllimet e përpunimit.

II.Ky vendim hynë në fuqi menjëherë.

T'i dërgohet:

- Kryetarit të Komunës
- Njësisë BNJ
- Arkivit
- Zyrtarit

